

JOLANDA BIBAJ

RENDI I MBIEMRAVE NDAJ FJALËS SË PËRCAKTUAR

Abstrakti

Në përgjithësi, mbiemrat në shqipe vendosen pas emrave që përcaktojnë si p.sh.: *qytet i bekuar, vajzë e vogël, libër i bukur, diskutim interesant* etj. Kjo vendosje kërkohet nga vetë natyra e gjuhës sonë. Pozicioni i sotëm i mbiemrit është i lidhur me nyjen e përparme, e cila shërben si mjet plotësues së mbiemrit në lidhjen dhe përshtatjen me emrin që përcakton. Nëse emrat dhe mbiemrat do të kishin pasur mjete të tjera gramatikore që do të shprehin këtë lidhje, si p.sh. mbaresa të njëjta, si dhe vendi i mbiemrit të kishte qenë i ngulitur, atëherë si mjet gramatikor tregues i lidhjes së emrit me mbiemrin do të kishte qenë topika e tij. Rendi i mbiemrit ka ndikuar edhe për ta dalluar atë nga gjymtyrë të tjera të fjalisë në brendësi të së cilës realizohen funksionet e ndryshme sintaksore. Kështu në sintagmën mbiemërore, mbiemri paraqet elementin kokë, ose nivelin zero, i cili duke u bashkuar me një komplement projektion nivelin e ndërmjetëm, i cili nga ana e tij mund të bashkohet me një specifikues për të formuar nivelin maksimal¹ ose ndryshe AP. Ndër të tjera mund të themi se nyja shërben për ta dalluar mbiemrin nga ndajfolja, ose nga emri pranë të cilit qëndronte vazhdimisht, por që s'dallohej prej tij nga pikëpamja strukturore (e kemi pohuar edhe më parë që shpesh disa mbiemra nuk dallojnë nga emrat: *djalë fshatar, fshatari* punon tokën).

Fjalë kyçe: mbiemër, rend, fjalë përcaktuese.

Mbiemrat në gjuhë të tjera kanë një rend dhe topikë ndryshe nga shqipja. Në anglishte p.sh. mbiemrat vendosen para mbiemrave, por edhe në vendosjen e tyre përpara ka një lloj hierarkie. Në këtë gjuhë tjetër, renditja e disa mbiemrave njëri pas tjetrit është i mundur, madje ka tendenca të mirëfillta gjuhësore sa i përket rendit të mbiemrave. Kjo

¹ F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2011, f. 41.

tendencë në një analizë më të hollësishme gjuhësore lejon që mbiemrat paraemërorë të përmasës të vendosen para atyre që tregojnë ngjyrë. Rendi më i zakonshëm në vendosjen e disa mbiemrave është si më poshtë:

Mb_{sasior}>Mb_{cilësor}>Mb_{përmasor}>Mb_{formë}>Mb_{ngjyrë}>Mb_{kombësi}

Scott (2002) e shtrin këtë analizë duke propozuar një hierarki edhe më të përimtë:

Rreshtorë > Themelorë > Komenti i subjektit > Dëshmues > Përmasa > Gjatësia > Pesha > Shpejtësia > Thellësia > Gjerësia > Temperatura > Lagështia > Mosha > Forma > Ngjyra > Origjina / kombësia > Materiali.

Ndërsa Laenzlinger (2005) sugjeron që inventari i Scotit mund të organizohet në 5 nëndarje:

[_{sasiorët} Rreshtorë>Themelorë] >

[i orientuar nga ligjërimi Komenti mbi subjektin> Dëshmues] >

[pronësitë e shkallëzimit fizik Përmasa> Gjatësia> Pesha> Shpejtësia> Thellësia> gjerësia] >

[masa Pesha>Temperatura>Lagështia> Mosha] >

[pronësitë e pashkallëzueshme fizike Forma>Ngjyra> Kombësia/Origjina>Materiali]²

Qoftë në njërën apo në tjetrën analizë, vërehet se mbiemrat e dimensioneve paraprijnë në mënyrë të vazhdueshme mbiemrat e ngjyrës, origjinës apo materialit.

Mbiemri në gjuhën shqipe njihet dy përdorime: si përcaktor (epitet) dhe si kallëzuesor (predikat) dhe si i tillë mund të qëndrojë:

Mbas emrit të karakterizuar: *e quanin gjeneralin më të madh të kohërave, një avull i përzierë, një tym i rëndë, një mjegull e dendur.*

Para emrit të karakterizuar: *e bukur dhe bujare zonjë, i shkreti Lul.*

Mbas foljes bërthamë të sintagmës foljore: *paskam qenë i tepërt në këtë botë, ti s'do të quhesh ma e mjera.*

Para foljes bërthamë të sintagmës foljore: *e kandshme si vera kur çilin zymbylat.*

Rendi i mbiemrit si përcaktor është ai i prapavendosjes. Megjithatë përcaktorët e pavetëmjaftueshëm (mes të cilëve edhe mbiemrat e nyjshëm)

² P. Svenonius, *The position of adjective and other phrasal modifiers in the decomposition of DP*, në *Adjectives and Adverbs, Syntax, Semantics and Discourse*, Oxford Studies in Theoretical Linguistics, Oxford University Press, 2008, f. 35.

Rendi i mbiemrave ndaj fjalës së përcaktuar

³ vendosen pas emrit, pa praninë e tij, ata përdoren në funksion kallëzuesori. Në raste të rralla, për arsye stilistike, mbiemrat vendosen para emrit: *i ziu baba, të njëjtën fytyrë, fati i të mjerit jetim* etj. Mbiemrat që dalin para emrave mund të jenë zakonisht në pohore, krahasore, rrallë në sipërore, si p.sh.: *i miri djalë, më i zgjuari gjeneral, e zeza nënë, shumë i nderuari zotëri* etj. Mbiemrat e paravendosur lakohen si emrat e shquar: *i miri djalë, i të mirit djalë, të mirit djalë, të mirin djalë* etj.

Përcaktori i shprehur me mbiemër të nyjshëm, zakonisht, vendoset pas gjymtyrës së përcaktuar, por në ligjërim ndeshet edhe rendi mbiemër i nyjshëm – emër. Ky rend është karakteristik sidomos për rreshtorët dhe për disa mbiemra që tregojnë cilësi.⁴ P.sh.:

Më të mirën verë në Shqipëri e prodhon Kallmeti.

Megjithëse në këtë përdorim mbiemri pëson ndryshime formale, merr treguesit e emrit kurse emri vetë paraqitet i pandryshueshëm, përsëri kjo vendosje e spikat më shumë emrin, vë më në dukje cilësinë e tij sesa në rendin e zakonshëm emër + mbiemër.

Megjithë rendin, thuajse të ngulitur të mbiemrit pas emrit, sintaksa poetike preferon shpesh rendin e kundërt. Nuk është e rrallë të gjejmë të përdorur në sintagma poetike, një rend të tillë:

2. a. *Besa ka një t' madhe zi!*,

b. *Me njat t'bukurën histori* (Gj. Fishta, Mrizi i Zanave”, Uegen, Tiranë, 2008, f. 32.)

Po kështu një rend të përmbysur kemi edhe në rastet kur theksohet kuptimi i përcaktorit të shprehur me mbiemër cilësor: *I mjeri jetim, veç të zeza kishte parë në jetë!*

Një topikë të tillë e kanë edhe përcaktorët e shprehur me fjalë si: *goxha, alamet, deli, lule* etj., për shkak të përmbajtjes, që e sjell me vete theksimin e tiparit, si në shembullin:

³ Sh. Demiraj, *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe* (botim i përmbledhur), Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002, f. 207.

⁴ Th. Rushi, *Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e sotme*, SF/ 1, 1985, f. 118.

3. a. *Një goxha peshk, kishte hyrë në rrjetë.*
b. *Kishte zgjedhur për dhëndër një alamet djali!*

Në lidhje me rendin e mbiemrave në sintagmë duhet thënë se ka një rregullësi të caktuar:

Në qoftë se kemi të bëjmë me një pronor dhe një mbiemër (ose dy mbiemra të bashkërenditur), atëherë mbiemri vendoset pas pronorit. Si në shembujt: *nxënësit tanë punëtorë, institucionet e tjera qeveritare, shprehje e dashurisë së saj të zjarrtë.*

Nëse kemi të bëjmë me dy a më shumë mbiemra të një fare (të dy të panyjshëm, ose të dy të nyjshëm), rendi i tyre zakonisht është, nga mbiemri që tregon një nocion të përgjithshëm tek ai që tregon një nocion më të ngushtë, më të veçantë⁵, si p.sh. *rinisë femërore shqiptare, popullit kreshnik shqiptar, kënga popullore shkodrane*. Por kur njëri mbiemër është një përcaktues më i afërm i mbiemrit tjetër, atëherë zakonisht përcaktuesi është në vend të dytë, pavarësisht nga gjerësia e nocionit që shpreh, si në shembujt: *vajzë e mirë dhe e urtë, djalë trim e punëtor.*

Mbiemrat e panyjshëm, që zakonisht përdoren pas emrit, për arsye stilistike-emocionale, mund të vendosen edhe para emrit. Ky rend është tipik për sintaksën poetike si p.sh. *i ëmbël rrëfim, e bukur ëndërr, i kobshëm trishtim*

Kur, gjatë përdorimit, gjenden dy mbiemra të përzier, të nyjshëm e të panyjshëm, atëherë në fillim vendosen mbiemrat e nyjshëm pastaj të panyjshmit, si p.sh.: *ideali më i lartë estetik, sulmi më i madh ushtarak, një punë më e madhe edukuese, sllavishte e vjetër kishtare*, etj. Një rregull i tillë pohohet edhe nga studiuesi Th. Rushi: “*Në qoftë se njëri nga përcaktorët shprehet me mbiemër të nyjshëm dhe tjetri me mbiemër të panyjshëm, rendi i zakonshëm, në përputhje me normën është: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm.*”⁶

Rendi tjetër që është i mundshëm të gjendet është: emër + mbiemër + emër në rrjedhore (E₅). Megjithëse ky rend nuk është gjithmonë i qëndrueshëm duke qenë se jo rrallë haset edhe rendi i kundërt, çka flet për prirjen që kanë këto sintagma për t’u bërë të qëndrueshme, por edhe për t’u trajtuar gramatikisht si të ishin një fjalë e vetme. Kështu mund të gjenden

⁵ A. Dhrimo, *Vëzhgime rreth ngulitjes së normës gjuhësore në publicistikën e pasçlirimit*, SF/3, 1969, f. 141.

⁶ Th. Rushi, *Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e sotme*, SF/1, 1985, f. 119.

Rendi i mbiemrave ndaj fjalës së përcaktuar

shembuj të tillë si: *volum pune më i madh, sipërfaqe toke më të përmbytura se vjet, modele këpucësh të reja.*

Një tjetër rend i mundshëm është edhe rendi: emër + mbiemër marrëdhënior + mbiemër cilësor, ku mbiemri marrëdhënior tregon një lidhje më të ngushtë me emrin që përcakton se mbiemri që tregon cilësinë e tij. Këtë mund ta shohim në shembullin: “*Në ket mbramje maji t’vokë*”, (M. Camaj, Vepra letrare 1, Apollonia, 1996, f. 104.)

Në ligjërimin e përditshëm mund të gjendet edhe rendin i anasjelltë i përcaktorëve: emër + mbiemër i panyjshëm + mbiemër i nyjshëm. Ky rend shfaqet në raste të tilla kur emri i përcaktuar me mbiemrin kanë një lidhje të ngushtë dhe emërtojnë një send të vetëm, si p.sh. *këmishë blu e errët, mollë vjeshitore e thartë* etj. Ky rend gjithashtu haset kur mbiemri i nyjshëm zgjerohet me gjymtyrë të tjera: *Ky perëndim mbrëmësor kaq i përskuqur i pëlqeu jashtëzakonisht.*

Në sintagmën determinante, pjesë e së cilës kemi thënë që është edhe SMb, determinantët renditen para mbiemrave. Në këtë klasë hyjnë: nyjet, pronorët, dëftorët, si: *ky, kjo, këta, ata*; disa sasiore të tillë si rreshtorët: *të dy, të gjithë, të parët*. Nëse ky numëror përdoret bashkë me determinantë të tjerë, numërori pozicionohet pas determinantit:

4.a. *Mora tre lapsa të zinj nga seti i lapsave.*

Nuk është i mundur rendi i kundërt sepse fjalia do të dilte jogramatikore:

b. **Mora tre të zinj lapsa nga seti i lapsave.*

Edhe kur përdoret bashkë me determinantë të tjerë, rendi ruhet i tillë:

c. *Mora këta/ata tre lapsa të zinj nga seti i lapsave.*

Nuk mund të thuhet: ** Mora këta të zinj tre lapsa nga seti i lapsave.*

Në bashkëshoqërim me pronorët rendi është i tillë:

d. *Këta tre djemtë e mi të vegjël.*

Nga kjo paraqitje e shkurtër, u pa se pavarësisht rendit normal të mbiemrave pas emrit që përcaktojnë, ata mund të kalojnë edhe në pozicion paraemëror. Megjithatë kjo vendosje ka nevojë për sqarime më të hollësishme, thënë ndryshe duhen parë cilat kategori semantike ose strukturore mund të paravendosen dhe cilat jo. Paravendosja ose pasvendosja do parë në lidhjen e ngushtë me gjymtyrën që përcakton mbiemri.

Sa i përket këtij problemi, ka një grup të veçantë mbiemrash që mund të paravendosen, të tillë janë mbiemrat:

Në shkallën pohore emërtojnë karakteristika shpirtërore, morale a shoqërore, (d.m.th. përdoren me kuptim afektiv), të tillë si: *e shkreta plakë, i larti Skënderbe* etj.

Mbiemrat cilësorë në shkallën krahasore: *më i vogli fëmijë, më i miri djalë* etj.

Mbiemrat numërorë: *i pari njeri, i dyti mendim* etj.

Mbiemrat *i njëjtë, i vetëm* që dalin rëndom para emrave: *në të njëjtën ditë, i vetmi njeri* etj.

Mbiemrat e panyjshëm me një ngjyrim të fortë emocional, por vetëm në rasën emërore e kallëzore. Këta mbiemra shprehin veti fizike e morale njërezish njëkohësisht: *zemërbardhi Vasil, xhevahir djalë, deli bir* etj.

Pra vërehet se përdorimi i mbiemrit para emrit kërkohet nga kuptimi i sintagmës, në të cilën kërkohet spikatja a vënia më në dukje e tiparit i cili dallohet për këtë arsye duke u vënë para emrit, dhe jo pas tij. Studiuesi M. Totoni⁷ pohon se paravendosja kushtëzohet nga kuptimi leksikor i mbiemrit dhe nga karakteri afektiv i frazës, por në poezi, si liri poetike, këto kufizime edhe mund të neutralizohen. Përkundrazi ka një kategori mbiemrash që nuk mund të vendosen para emrave, mes të cilëve do të përmendim:

Mbiemrat që emërtojnë një karakteristikë lëndore, kohore a vendore: *unazë e artë, ditë e sotme* etj.

Mbiemrat cilësorë me kuptim të drejtpërdrejtë në pohore ose në sipërore: *pemë e lartë, shtëpi e bukur* etj.

Arsyeja e mospërdorimit të këtyre mbiemrave në pozicion paraemëror duhet kërkuar tek emërzimi, për shembull: *Ai u vlerësua si më i miri i shokëve të tij!*, kemi emërzim të mbiemrit. Një përdorim i tillë nuk mund të themi se nuk është në përputhje me normën, as si rend i anasjelltë i përcaktorit të shprehur me mbiemër për dy arsye: së pari mbiemri merr treguesit e emrit, pra praktikisht kthehet në emër, dhe, së dyti nuk mund të flitet për dy gjymtyrë, emri së bashku me mbiemrin e paravendosur, përbëjnë një gjymtyrë të vetme.⁸

Në një përdorim të tillë shembulli *e bukura shtëpi* merr tiparet e emrit dhe humbet ato të mbiemrit duke u shfaqur në trajtën e shquar dhe duke humbur kuptimin e tij si identifikues e duke marrë atë individualizues, (nëse krahasojmë p.sh. *shtëpi të bukura, shtëpi e bukur*, ku

⁷ M. Totoni, *Vlerësimi morfologjik i 'Mbiemrit' të paravendosur dhe gjymtyrëzimi sintaksor i tij*, SF/2, 1991, f. 154.

⁸ Th. Rushi, *Rendi i gjymtyrëve të shkallës së dytë*, SF/1-2, 1988, f. 106.

Rendi i mbiemrave ndaj fjalës së përcaktuar

nuk kemi një dallim se cila mund të jetë, por nëse mbiemri kalon para i jep sintagmës një kuptim më specifik.)

Mbiemrat kanë një rend të ngulitur edhe në lidhje me gjymtyrë të tjera nga të cilat varen. P.sh. kundrinorët ose rrethorët që varen prej mbiemrave, zakonisht vendosen pas tyre.

5. Pas shpërthimi të municioneve, Gërdeci dukej si një fshat i sapodalë nga lufta.

Përdorimi dy mbiemrave të nyjshëm njëri pas tjetrit, sipas S. Floqit, nuk është normë në gjuhën shqipe, prandaj atij i duket më shumë si kalk nga frëngjishtja. Në mbrojtje të këtij pohimi, ai jep p.sh. shembullin e përdorimit të ngjyrave në flamurin tonë: *kuq e zi*, ku jepen dy mbiemra të panyjshëm.⁹

Përfundime

Rendi i mbiemrave në shqipe është pas gjymtyrës që përcaktojnë. Në rastet kur mbiemri del përpara emrit ose gjymtyrëve të tjera, kjo bëhet për arsye stilistike (në rastin e sintagmave poetike), si dhe për ta specifikuar më shumë atë. Përdorimi i dy mbiemrave rresht, në varësi të llojit të tyre cilësor apo marrëdhënior, ka rregulla të përcaktuara qartë. Mund të vendosen para ata mbiemra që përfaqësojnë karakteristika shpirtërore a morale, siç quhen ndryshe mbiemrat psikologjikë, mbiemrat numërorë rregullisht vendosen para emrit, mbiemrat me ngjyrim të fortë emocional, mbiemrat cilësorë në shkallën krahasore. Ndërsa nuk mund të dalin para emrave mbiemrat (marrëdhëniorë) që shfaqin një lidhje të ngushtë lëndore, kohore a vendore si dhe mbiemrat cilësorë me kuptim të drejtpërdrejtë në pohore ose në sipërore.

BIBLIOGRAFIA

- Demiraj, Sh., *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe* (botim i përmbledhur), Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002.
- Dhrimo, A., *Vëzhgime rreth ngulitjes së normës gjuhësore në publicistikën e pasçlirimit*, SF/3, 1969.
- Koleci, F., Turano, G., *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2011.

⁹ S. Floqi, *Togfjalëshat mbiemërorë në shqipen e sotme letrare*, II, SF/ 2, 1981, f. 93.

- Rushi, Th., *Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e sotme*, SF/ 1, 1985.
- Rushi, Th., *Rendi i gjymtyrëve të shkallës së dytë*, SF/1-2, 1988.
- Svenonius, P., *The position of adjective and other phrasal modifiers in the decomposition of DP*, në *Adjectives and Adverbs, Syntax, Semantics and Discourse*, Oxford Studies in Theoretical Linguistics, Oxford University Press, 2008.
- Totoni, M., *Vlerësimi morfologjik i 'Mbiemrit' të paravendosur dhe gjymtyrëzimi sintaksor i tij*, SF/2, 1991.